



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E ADMINISTRATËS
PUBLIKE**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Ministritsë së Administratës Publike*, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm z. *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Muhamet Balaj* – udhëheqës i ekipit, *Qëndresa Sogojeva* dhe *Lumturije Sopi* - anëtare, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Blerim Kabashi*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	19
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	27
Shtojca II: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit	30

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Administratës Publike për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23.11. 2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Administratës Publike.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i Kualifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç shpenzimeve për paga në vlerë prej 99,916€ për stafin që nuk ka punuar dhe shpenzimet për tri objekte të marra me qira në vlerë prej 121,989€, por të cilat asnjëherë nuk janë shfrytëzuar nga ana e stafit për të cilët është paguar qiraja.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shuma prej 588,300€ ishte buxhetuar dhe shpenzuar si investim kapital, ndërsa sipas natyrës kualifikohen si mallra dhe shërbime. Gjithashtu, pasuria kapitale me vlerë 251,221€ nuk është regjistruar në regjistrin kontabël dhe stoku është mbivlerësuar për 310,525€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II (*plotësohet vetëm në raport final*).

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Administratës Publike për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinionin të kualifikuar

Shpenzimet për paga në vlerë prej 99,916€ për 20 punëtorë të cilët nuk kanë vijuar orarin e rregullt të punës dhe shpenzimet për tri objektet e marra me qira në vlerë prej 121,989€¹, por të cilat nuk janë shfrytëzuar, konsiderohen shpenzime të parregullta të buxhetit. Arsyeja për këto pagesa është së Qeveria e Kosovës me marrëveshjen e Brukselit për shuarjen e të ashtuquajturës "mbrojtja civile" ka marrë për obligim të integroj këtë komunitet në institucionet e shtetit.

Për qëllime akomodimi të stafit prej 224 personash, MAP që nga viti 2016 ka lidhur tri kontrata për marrjen me qira të tri objekteve. Përkundër përpjekjeve të Ministrisë për të krijuar kushte për punë

¹ (a) Ndërtesa në Mitrovicën Veriore - objekti është i gatshëm për akomodimin e zyrtarëve, (b) Ndërtesa në Zubin Potok - objekti është i gatshëm pas renovimit, por nuk ka inventarë për akomodimin e zyrtarëve në atë ndërtesë dhe (c) Ndërtesa në Leposaviq - objekti nuk është i gatshëm pasi që renovimi ende nuk është përfunduar si dhe nuk është vendosur inventari për akomodimin e zyrtarëve.

për këtë komunitet, nuk është arritur qëllimi i integritetit të tyre pasi ka ndodhur një sulm në objektet ku do duhej të filloj puna, si dhe ka pasur kërcënime tjera të vazhdueshme. Prandaj, për shkaqe të sigurisë së këtyre punëtorëve, dhe pjesërisht edhe për shkaqe të objekteve në të cilat ende nuk është përfunduar renovimi, Ministria nuk ishte në gjendje t'i angazhoj në punë stafin e kontraktuar. Nuk është e qartë si mund të paguhet qira për dy objektet të cilat nuk janë të gatshme për përdorim, dhe në të cilat edhe po të krijoheshin kushtet, stafi nuk mund ta filloj punën.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga Ministria dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin:

- Ministria ka shpenzuar nga kategoria investime kapitale shumën 500,000€ për shërbimin "Mbështetje për zbatimin e reformës së administratës publike" i cili është rezultat i buxhetimit jo të drejtë dhe është vazhdimësi e vitit të kaluar. Gjithashtu, furnizim me inventarë në Universitetin e Mitrovicës në vlerë prej 88,300€ që do duhej të financohej nga kategoria e mallrave. Kjo ishte si rezultat i buxhetimit fillestar jo të drejtë të projektit;
- Gjashtë pasuri kapitale me vlerë totale prej 251,221€ nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të vitit 2018. Kjo për shkak të kujdesit jo të duhur dhe problemeve me sistemin e pasurive në fund të vitit; dhe
- Stoku-pajisje rezervë dhe material për zyre, është mbivlerësuar për 310,525€. Kjo pasuri përveç që është evidentuar në stok, e njëjta është evidentuar edhe në regjistrin kontabël mbi 1000€ dhe në regjistrin E pasuria si pasuri jo kapitale. Këtë gjendje e ka shkaktuar mungesa e njohurive se çfarë konsiderohet stok dhe në cilin regjistër duhet të evidentohet kjo pasuri.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së Nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare Nr. 01/2013 Për Shpenzimin Parave Publike, Rregullën Financiare Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare dhe Rregulla Nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin përfundimtar të prokurimit; dhe
- Raportin e vetëvlerësimit.

Lidhur me PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I MINISTRISË SË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale dhe çështje tjera.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi A1 Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e parregullta për pagat e tyre. Gjithashtu duhet analizuar edhe nevojën për pagesat e qirasë për objektet të cilat aktualisht nuk janë të gatshme për përdorim. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, Ministri rekomandohet që çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj se do të rritet kujdesi gjatë hartimit të buxhetit duke i klasifikuar drejt shpenzimet sipas planit kontabël i aprovuar nga ana e Thesarit-MF dhe udhëzimit administrativ 05/2018 për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj funksionimin adekuat dhe sistematik të kontrollit lidhur me plotësinë e regjistrave të pasurisë dhe se Pasqyrat Financiare Vjetore do t'i nënshtrohen rishikimit dhe vlerësimit rigoroz nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, para se deklarata të nënshkruhet dhe PFV të dorëzohen në Ministrin e Financave.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar pjesërisht një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	21,967,101	20,901,348	20,818,378	19,597,632	17,177,447
Granti i Qeverisë -Buxheti	21,967,101	20,876,260	20,797,772	19,580,107	16,880,628
Donacionet e jashtme	-	25,088	20,606	17,525	37,523
Financimi nga huamarrja	-	-	-	-	259,296

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,065,753€ apo 5%. Rezultat i ndryshimeve buxhetore është zvogëlimi i grantit qeveritar prej 1,090,841€ me vendimet e Qeverisë dhe rritjes së donacioneve të jashtme në vlerë 25,088€.

Në vitin 2018, MAP ka shpenzuar 99.6% të buxhetit final ose 20,818,378€, me një performancë pothuajse të njëjtë me vitin paraprak.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	21,967,101	20,901,348	20,818,378	19,597,632	17,177,447
Pagat dhe Mëditjet	2,162,149	2,154,231	2,154,231	2,063,194	2,037,671
Mallrat dhe Shërbimet	5,762,352	6,207,440	6,154,265	6,538,365	5,067,846
Shërbimet komunale	2,949,600	2,269,606	2,261,115	2,470,035	2,265,998
Subvencionet dhe Transferet	-	-	-	-	50,000
Investimet Kapitale	11,093,000	10,270,071	10,248,767	8,526,038	7,755,932

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Në kategorinë paga dhe mëditje zvogëlimi i buxhetit final krahas buxhetit fillestar prej 7,918€ është rezultat i vendimit të Qeverisë nr.07/80, për shkak të tepricave buxhetore të ministrisë. Buxheti për këtë kategori është realizuar në tërësi.
- Rritja e buxhetit final krahas buxhetit fillestar për mallra dhe shërbime prej 445,088€ është rezultat i transferimit të mjeteve nga buxheti i kategorisë shërbimeve komunale për 420,000€ me kërkesë të ministrisë, dhe donacioneve të jashtme prej 25,088€. Realizimi i buxhetit për këtë kategori është 99%.
- Zvogëlimi i buxhetit final për shërbimet komunale për 679,994€ apo 23% krahas buxhetit fillestar është rezultat i bartjes së mjeteve prej 420,000€ në kategorinë mallra dhe shërbime dhe tepricave buxhetore me Vendimet e Qeverisë (nr.11/79, nr. 07/80 dhe nr. 12/81), realizimi i buxhetit për këtë kategori është 100%.
- Zvogëlimi i buxhetit final krahas buxhetit fillestar në investime kapitale në vlerë prej 822,929€ apo 7%. Ky ndryshim është rezultat i shkurtimeve buxhetore në vlerë 1,130,901€ dhe i rritjes së buxhetit në vlerë 307,972€ me Vendimet e Qeverisë (nr. 04/74, nr. 07/80 nr. 07/69, nr. 08/76, nr. 11/79, nr. 12/81). Realizimi i buxhetit për këtë kategori është pothuajse 100%.

3.1.1 Të Hyrat

Ministria nuk planifikon të hyra të rregullta me buxhet. Gjatë vitit 2018 janë realizuar të hyra në vlerë prej 35,902€ si rezultat i shitjes së veturave të përdorura në nivel të Qeverisë në vlerë prej 32,985€, shitja e pasurisë jashtë përdorimit në vlerë 2,340€ dhe të hyrave nga kompania e sigurimit prej 577€.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti fillestar për vitin 2018 është 2,162,149€ ndërsa ai final është 2,154,231. Realizimi i buxhetit final është 100%. Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar "Peyroll", numri i stafit është 277 persona.

Lidhur me parregullsitë të pagat dhe mëditjet, referoju kapitullit 2.1 opinionit të auditimit respektivisht bazës për opinion të kualifikuar.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për vitin 2018 për mallra dhe shërbime është 6,207,440€, ndërsa realizimi ishte 6,154,265€ apo 99% e buxhetit. Shpenzimet për këtë kategori kanë të bëjnë me: shpenzime për udhëtime zyrtare, furnizim me licenca inxhinierie/microsoft, mirëmbajtje e ndërtesave qeveritare, dhe furnizim me material për zyre.

Buxheti final për vitin 2018 për shërbime komunale është 2,269,606€, realizimi ishte 2,261,115€ e buxhetit apo 100%. Në kuadër të shërbimeve komunale ministria paguan: Energji elektrike për 53 institucione shtetërore, furnizim me ujë për 54 institucione, pagesa për grumbullim të mbeturinave për 35 institucione dhe ngrohje për 17 institucione.

Çështja A3³ - Marrëveshje për shërbime të veçanta për pozita të përhershme dhe më gjatë se gjashtë muaj (MSHV)

³ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura

-
- Gjetja** Sipas nenit 12 të Ligjit për Shërbyes civil nr.03/L-149, organizata buxhetore mund të angazhojnë punëtorë me afat të caktuar në bazë të kontratave “Marrëveshje për shërbime të veçanta”, për më pak se gjashtë muaj. Ministria ka vazhduar angazhimin e kontratave për shërbime të veçanta jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Ky numër ka arritur në 28, ndërsa 14 prej tyre i kanë me shume se gjashtë (6) muaj të punësuar me këtë lloj kontrate. Angazhimi i tyre është në pozitat e përhershme të punës që parashihet të jenë të punësuar të rregullt. Nevoja për staf shtesë dhe moskujdesi për të plotësuar katër (4) vendet e lira të aprovuara me buxhet, ka shkaktuar vazhdimin e këtyre kontratave.
- Rreziku** Angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta për pozita të rregullta si dhe pa procedurë dhe në mungesë të transparencës, rritë rrezikun për plotësimin e pozitave me staf jo kompetent që nuk kanë arsimin dhe eksperiencën e duhur për të kryer punët e tyre.
- Rekomandimi A3** Ministri duhet ndërmarrë veprime për tu siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta /kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Çështja B 2 - Shpenzime shtesë nga pagesat me vendime gjyqësore

- Gjetja** Sipas dispozitave të nenit 39, paragrafi 1,të LMFPP, obligim i vonuar për pagesë i organizatës buxhetore konsiderohet fatura e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimit nga ana e organizatës. Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë kryer tri (3) pagesa në vlerë 11,223€ me vendime gjyqësore. Këto pagesa kanë rezultuar edhe me pagesën e shpenzimeve shtesë (shpenzime për shërbimet e gjykatës) prej 1,973€, për shkak të mos ekzekutimit me kohë të këtyre pagesave.
- Rreziku** Ekzekutimi i pagesave të tilla ndikon në prishjen e ekuilibrit buxhetor dhe rritë rrezikun që projeksionet fillestare të mos realizohen.
- Rekomandimi B2** Ministri të siguroj se obligimet e papaguara duhet të trajtohen me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha faturat.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2018 është 10,270,072€, të cilat pothuajse ishin realizuar në tërësi- 10,248,767€. Shpenzimet lidhur me investimet kapitale përfshijnë ndërtimin e ndërtesave arsimore, objekte administrative dhe pajisje të teknologjisë informative (softuer dhe harduer).

Përveç çështjeve të prezantuara në kapitullin 2.1 opinionin e auditimit, respektivisht theksimi i çështjes, ne kemi identifikuar edhe çështjet si më poshtë:

Çështja A4 - Nënshkrimi i kontratave pa buxhet të mjaftueshëm

Gjetja

Sipas ligjit për buxhet 2018, nr. 06/L-020, neni 12, pika 6 përcakton se nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga organizatat buxhetore vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2018 dhe për dy (2) vitet në vijim. Ne kemi identifikuar katër (4)⁴ raste që ministria ka nënshkruar kontratat me vlerë më të lartë së buxheti i planifikuar për këto projekte:

- *“Ndërtimi i objektit të Komisionit të Pavarur për Media”* në vitin 2018 ministria kishte nënshkruar kontrata me vlerë 1,048,883€, ndërsa për periudhën tre vjeçare, të buxhetuara janë 640,000€;
- *“Ndërtimi i shkollës profesionale në Komoran”* në vitin 2018 ministria kishte nënshkruar kontrata me vlerë 2,845,381€, për periudhën tre vjeçare të buxhetuara ishin 1,600,000€.
- *“Ndërtimi i shkollës në Fushticë e Epërme – Drenas”* në vitin 2018 ministria kishte nënshkruar kontrata me vlerë 763,826€, ndërsa për periudhën tre vjeçare të buxhetuara ishin 480,000€.
- *“Ndërtimi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë”*, në vitin 2018 ministria kishte nënshkruar kontrata në vlerë 493,092€ për periudhën tre vjeçare të buxhetuara ishin 160,000€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti ka parashikuar se këto projekte nuk mund të përfundojnë për tri vite, dhe se mjetet do t'i buxhetojnë në vitet në vazhdim.

⁴ Sipas Ligjit Buxhetit Nr. 06/L-020 tabela 3.2 projekte kapitale për periudhën 2018-2020, 1. “Ndërtimi i objektit të Komisionit të Pavarur për Media” vlera e buxhetuar e projektit 640,000€, 2. “Ndërtimi i shkollës profesionale – Komoran” vlera e buxhetuar e projektit 1,600,000€, 3. “Ndërtimi i shkollës në Fushticë e Epërme – Drenas” vlera e buxhetuar e projektit 480,000€ dhe 4. “Ndërtimi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë” vlera e buxhetuar e projektit 160,000€.

Rreziku Nënshkrimi i kontratave pa ndarjet përkatëse buxhetore, rritë rrezikun e përmbushjes së kontratave dhe mundësinë e përballjes së ministrisë me konteste gjyqësore në të ardhmen.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që për të gjitha projektet kapitale të bëj planifikimin e duhur për të gjitha vitet, dhe çdo kontratë të ketë buxhet të mjaftueshëm për financimin e detyrimeve kontraktuese.

Çështja A5 - Tejkalimi i vlerës së paradhënies

Gjetja Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 06/L-020 për vitin 2018, neni 13 pika 4, kufizon që paradhënia në muajin dhjetor të bëhet deri në 5% të vlerës së kontratës.

Ministria për dy projekte ka paguar paradhëniet më të larta se ajo që është e lejuar me ligj. Me datën 06.12.2018, për projektin “Ndërtimi i Qendrës për Vlerësim dhe Standarde”, me vlerë të kontratës 1,965,600€, ishte paguar paradhënia prej 161,443€ apo 8% të vlerës së kontratës, e që mund të paguhej deri në 98,280€.

Me datë 10.12.2018, për projektin “Ndërtimi i Institucionit Parashkollor – Prizren”, me vlerë të kontratës 727,273€, ishte paguar paradhënia prej 72,730€, apo 10% e vlerës së kontratës, por që mund të paguhej deri në 36,364€. Kjo ka ndodhur si rezultat i pakujdesisë të treguar nga zyrtarët përgjegjës dhe menaxhmenti për aprovimin e pagesave në emër të paradhënies.

Rreziku Pagesa e paradhënies më e lartë se vlera e përcaktuar me ligjin e buxhetit, rrezikon që mjetet të mos jenë përdorur për qëllimin e paraparë dhe mund të shkakton vështirësi në realizmin e projekteve tjera.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të forcoj masat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies të zyrtarëve përgjegjës me rastin e aprovimit të kërkesave për pagesat e paradhënies.

Çështja C1 - Mos arsyetimi i duhur paradhënies për projekte kapitale

Gjetja Neni 26.2 i kushteve të kontratës përcakton se kontraktuesi do të përdor parapagimin vetëm për blerje të materialit, pajisjeve dhe shpenzimeve tjera posaçërisht për kryerjen e punëve. Po ashtu, kontraktuesi duhet të prezantoj kopje të faturave ose dokumente tjera për menaxherin e projektit. Për projektet "Ndërtimi i objektit të Komisionit të Pavarura për Media", më datën 14.09.2018, është paguar në formë të avansit shuma prej 157,483€ dhe "Ndërtimi i shkollës profesionale në Komoran" me datë 19.09.2018 është paguara avansi në vlerë 186,000€, për të cilat operatorët ekonomik nuk kishin ofruar fatura apo dëshmi tjera për arsyetimin e avansit. Arsye e kësaj ishte mos kompetenca e zyrtarëve përgjegjës.

Rreziku Dhënia e avanseve nga MAP pa dëshmi të mjaftueshme nga OE për punët, blerjen e pajisjeve apo furnizimeve, mund të sjellë rreziqe që paraja publike të mos shfrytëzohet për qëllimin për të cilin është aprovuar avansi.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të rrisë kontrollet në menaxhimin e shpenzimeve për projekte kapitale dhe të siguroj se paradhëniet do të arsyetohen në mënyrën e duhur sipas kërkesave kontraktuese.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale e prezantuar në PVF është në vlerë 39,523,000 €, pasurit kapitalë përbehen prej investimeve në vijim, ndërtesave, pasuri fikse të paprekshme dhe pajisje të IT-së, pasuritë jokapitale kanë një saldo prej 160,000€ dhe stoqet prej 739,000€. Pasuritë kapitale menaxhohen përmes sistemit të Thesarit dhe ato jokapitale dhe stoqet me sistemin e-pasuria.

Çështja B3 - Dobësi në procesin e inventarizimit

Gjetja Sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare 02/2013, neni 19 respektivisht paragrafi 4.3 është detyrë e komisionit të inventarizimit të bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jo financiare. Komisioni i inventarizimit nuk ka bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë. Kjo, për shkak të mos kuptuarit të drejt të kërkesave të rregullores dhe mungesës së një udhëzimi të brendshëm të inventarizimit.

Rreziku Mungesa e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jo financiare nuk konfirmon ekzistencën reale të pasurisë dhe nuk mundëson prezantimin e gjendjes së plotë dhe të saktë të pasurisë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të qartësoj kërkesat rregullative, të nxjerrë udhëzime të brendshëm lidhur me inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe të trajtoj stafin relevant, në mënyrë që kërkesat e rregullore për pasuritë të zbatohen me konsistencë.

3.3 Obligimet e papaguara dhe detyrimet kontingjente

Ministria ka prezantuar në pasqyrat financiare vlerën prej 139,492€. Prej tyre, 78,250€ për mallra e shërbime, 1,842€ për komunalitet dhe 59,400€ (vetëm një faturë) për investime kapitale.

Ministria ka prezantuar në pasqyrat financiare detyrime kontingjente në vlerën prej 3,055,000€, që është një ngritje prej 15% krahasuar me vitin e kaluar ku niveli i obligimeve ishte 2,660,000€.

Çështja B4 - Hyrja në obligime pa fonde

Gjetja Sipas nenit 17.2 të rregullores 01/2017 Për raportim vjetor financiar, përcakton se organizatave buxhetore nuk i lejohet të hyjnë në detyrime gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Në fund të vitit 2018 ishin regjistruar obligime nga kategoria mallra dhe shërbime në shumë 78,250€ deri sa shuma e mbetur e buxhetit për këtë kategori ishte 55,515€ dhe për investimet kapitale obligimet janë në vlerë prej 59,400€, derisa mjetet e pashpenzuara janë vetëm 21,305€. Kjo tregon se ministria kishte hyrë në obligime pa fonde për 54,182€. Kjo ka ndodhur si pasojë e aranzhimeve jo-efektive të buxhetit nga ana e ministrisë dhe shkurtimeve buxhetore në fund të vitit me vendime të Qeverisë.

Rreziku Hyrja në obligime përtej ndarjeve buxhetore për kategoritë ekonomike të lartpërmendura tregon se planifikimi i buxhetit nuk është bërë në pajtim me nevojat e ministrisë, dhe si pasojë, ministria kishte mungesë fondesh për kryerjen e obligimeve.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të siguroj se shpenzimet e buxhetit i përmbahen kufijve buxhetor dhe mbi këtë bazë të bëhet edhe planifikimi i buxhetit dhe hyrja në detyrime kontraktuese.

Çështja B5 - Niveli i lartë i detyrimeve kontingjente

Gjetja Neni 46, pika b. (iv), e Ligjit Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, (me plotësim dhe ndryshime) përcakton një vlerësim të gjitha detyrimeve kontingjente, duke përfshirë një vlerësim të riskut të tyre. Në pasqyrat financiare janë prezantuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 3,055,000€, që krahasuar me vitin 2017 janë rritur për 395,000€ apo për 15%. Ministria nuk ka hartuar ndonjë politikë apo strategji për vlerësimin e rrezikut të këtyre detyrimeve. Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e menaxhmentit për të ndërmarrë veprime lidhur me menaxhimin efikas të detyrimeve kontingjente.

Rreziku Mungesa e vlerësimit të rrezikut për trajtimin e detyrimeve kontingjente, rrit mundësinë e shndërrimit të tyre në obligime faktike që do të shkaktonte vështirësi buxhetore në nivele të aktiviteteve dhe projekteve për ministrinë.

Rekomandimi B5 Ministri duhet të siguroj që për detyrimet kontingjente të bëhet një vlerësim i rrezikut me qëllim të planifikimit më të mirë financiar dhe daljes së mundshme të parasë gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të mos rrezikohen aktivitetet e përditshme të ministrisë nga aktgjykimet e papritura gjyqësore.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Ministria ka bërë vetëvlerësimin dhe listën e rreziqeve për vitin 2018 duke e konstruktuar edhe nivelin e rreziqeve sipas kategorive, megjithatë gjetjet tona vërtetojnë se veprimet e ministrisë nuk kanë qenë të mjaftueshme në funksion të parandalimit të gabimeve.

Si një nga aspektet e qeverisjes së mirë, ne kemi trajtuar edhe kontratat e MAP me shfrytëzuesit e hapësirave publike që ofrojnë shërbime hoteliere, të ushqimit dhe pijeve brenda hapësirave qeveritare. MAP ka kontrata të tilla në pesë lokacione qeveritare, por problemi me kontrata është identifikuar në tri raste:

- Ministria ka dështuar në ripërtëritjen e kontratave me kohë për shërbimet hoteliere, të ushqimit dhe pijeve brenda hapësirave qeveritare në ndërtesën e Kryeministrit, Pallatit të Drejtësisë dhe atë të Rilindjes.

Edhe vet MAP gjatë vitit 2018 kishte paguar shpenzime për dreka zyrtare dhe reprezentacion 21,866€, për kompaninë e cila kishte operuar pa kontratë valide.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Siç u tha më lart, ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda ministrisë, veçanërisht në lidhje me aktivitetet operative, llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura. Komiteti i auditimit është i themeluar, por përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve të NJAB janë në nivel të ulët.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës. Ministria e Administratës Publike ka hartuar strategji për modernizimin e administratës publike dhe strategjinë për trajnimin e nëpunësve civil, janë hartuar edhe programe përkatëse dhe harta të rreziqeve, por mungonte plani strategjikë i përgjithshëm që mbulon vitin 2018.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja C 2 – Dobësi në funksionimin e NJAB

- Gjetja** Nenet 5, i Ligjit nr.03/L-138 Për Auditimin e Brendshëmⁱ, përcakton se auditimet duhet të bëhen në pajtim me këtë ligj, rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, statuti i auditimit të brendshëm, kodin e etikës si dhe standardet profesionale të përgatitura nga NJQHAB dhe të shpallura nga Ministri sipas nenit 7.4. të këtij ligji. Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB-së, si:
- Nga shtatë raporte, në tre prej tyre fushëveprimi i auditimit është fokusuar në vitin paraprak dhe në fillim të vitit 2018. NJAB ka parë të arsyeshme rishikimin e disa ngjarjeve edhe nga periudhat e mëparshme.
 - Niveli i zbatimit të rekomandimeve ende vazhdon të jetë i ulët, vetëm 35% e rekomandimeve të dhëna ishin adresuar. Kjo, për shkak të mungesës së përkushtimit të njësive të audituara, për zbatimin e tyre.
 - Nga procesverbalet e komitetit të auditimit nuk mund të kuptojmë se ky komitet ka kontribuar në përmirësimin e funksionimit të NJAB, ngase nuk kishte dhënë asnjë rekomandim për përmirësim.

Rreziku Auditimet e kryera në periudhën paraprake, nuk i ndihmojnë përmirësimin të ngjarjeve dhe sistemit në vitin aktual dhe organizatës në përgjithësi. Angazhimi i pamjaftueshëm i menaxhmenti dhe njësisve të audituara për adresimin e rekomandimeve të dala nga NJAB dhe mos kontributi i komitetit të auditimit, rritë rrezikun që dobësitë e identifikuar të mos korrigjohen, dhe si të tilla, të përsëriten.

Rekomandimi C2 Ministri duhet të siguroj që fushëveprimi i auditimit të jetë për vitin aktual me qëllim që eliminimi i mangësive në sisteme të bëhet me kohë, e jo pasi që ngjarjet të kenë përfunduar, të ndërmer masa që rekomandimet e dhëna nga NJAB të adresohen dhe komitetin e auditimit të mbaj përgjegjës për rolin mbikëqyrës.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje, menaxhmentit ka nevojë të posedoj përveç raporte të rregullta dhe specifike edhe të regjistroj procesverbalet ku do të mund të kuptohen përfundimet e nxjerra nga diskutimet dhe aktivitetet që do të ndërmerren. E gjithë kjo me qëllimin e vetëm që llogaridhënia si proces i pranimit të përgjegjësive, të jetë e qartë për personat përgjegjës lidhur me veprimet e tyre duke shpalosë rezultatet në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime specifike në këtë fushë, përveç atyre të dhëna në kapitujt paraprak.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të Ministrisë së Administratës Publike ka rezultuar në gjithsej 18 rekomandime. Ministria ka përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, tre (3) rekomandime janë zbatuar, dy (2) ishin në proces, shtate (7) të mbyllura pazbatuar dhe gjashte (6) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni tabelën 4 (ose tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

N r	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar për Theksim të Çështjes, si dhe të merren veprimet e duhura për të siguruar prezantim të drejtë dhe të saktë të PFV, përmes regjistrimit/klasifikimit të plotë dhe të drejtë të shpenzimeve dhe të pasurive.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pa zbatuara.
2	Ekzekutimi i buxhetit	Ministri duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit dhe realizimit të projekteve.	Janë ndërmarr veprime të mjaftueshme.	Rekomandim i zbatuar.
3	Paga dhe shtesa	Ministri duhet të ndërmarr veprime të menjëhershme që të siguroj menaxhim të mirë të shtesave. Të merren veprime për një shqyrtim që identifikon të gjitha pozitat deficitare aktuale dhe vlerën e saktë financiare të këtyre shpenzimeve. Gjithashtu, të siguroj se të gjithë zyrtarët marrin shtesa sipas pozitave përkatëse, standardeve kualifikuese, të përcaktuara në vendimin e Qeverisë.	Nuk janë ndërmarr veprime, për korrigjim.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
4	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj kontrole të mira në menaxhimin e kontratave duke parandaluar devijimet kontraktuale, për të mundësuar që shërbimet të zhvillohen në pajtueshmëri me kontratat dhe të sigurohet vlera për para.	Nuk janë ndërmarr veprime, për korrigjim.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
5	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj kontrole dhe menaxhim adekuat në fushën e prokurimit. Koordinimi me AQP duhet të zhvillohet me qëllim që të përdoren procedura adekuate e prokurimit duke promovuar konkurrencë të mirëfilltë dhe të arrihet vlera për para.	Nuk janë ndërmarr veprime për korrigjim.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
6	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë se përgatitja e specifikacionit për sigurimin e ndërtesave qeveritare të bazohet në informata të bazuara për vlerën reale (të tregut) të pasurisë e cila sigurohet, dhe pastaj mbi bazën e kësaj të zhvillohen procedurat e prokurimit.	Nuk janë ndërmarr veprime për korrigjim.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.

7	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të forcoj kontrollet rreth disiplinës financiare në Ministri. Pagesa e faturave të bëhet në kohë dhe evidenca të plota/sakta mbi detyrimet. Pagesa e detyrimeve të trajtohet me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pazbatuar.
8	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet t'i forcojë kontrollet mbi aktivitetet e Ministrisë me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare, më qëllim që këto shpenzime të jenë në funksion të mirëfilltë të përfaqësimit dhe objektivave të ministrisë.	Nuk janë ndërmarr veprime për korrigjim.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
9	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë se respektohet afati ligjor për mbylljen e avancave duke siguruar llogaridhënie për paranë e shpenzuar si dhe të kërkoj kthimin e mjeteve në kohën sa më shkurtër që është e mundur.	Janë ndërmarr veprime të mjaftueshme .	Rekomandim i zbatuar.
10	Investime kapitale	Ministri duhet të siguroj mbikëqyrje dhe kontrolle adekuate/rigoroze mbi kontratat për projekte kapitale dhe mbi organet mbikëqyrëse të punëve. Në bazë të rastit të identifikuar nga auditimi, menaxhmenti të ngrisë mekanizmat për kontroll më të avancuar në mbikëqyrjen e kontratave dhe pagesave për projektet kapitale.	Nuk janë ndërmarr veprime për korrigjim.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
11	Investime kapitale	Ministri duhet të rrisë kontrollet në menaxhimin e shpenzimeve për projekte kapitale dhe të siguroj se paradhëniet do të ndodhin me arsyeshmëri të duhur sipas kërkesave ligjore dhe kontraktuale.	Janë ndërmarrë veprime të përsëritshme .	Rekomandim i pjesërisht i zbatuar
12	Çështje e përbashkët	Ministri duhet të sigurojë që zyrtaret përgjegjës të buxhetit të përgatitin planifikimin e projekteve mbi bazën e disponueshmerisë së fondeve. Po ashtu të siguroj se nuk do të fillojnë asnjë projekt pa pasur fonde të mjaftueshme.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pazbatuar
13	Pasuri kapitale	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që menaxhimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe prezantimit të saktë të pasurisë në PFV.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pazbatuar
14	Obligimet	Ministri duhet të siguroj se shpenzimet e buxhetit i përmbahen kufijve buxhetor dhe mbi këtë bazë të bëhet planifikimi i buxhetit dhe plani i rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar buxhetin në dispozicion.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pazbatuar

15	Obligimet	Ministri duhet të siguroj se detyrimet kontingjente trajtohen me kujdes me qëllim të planifikimit më të mirë financiar, të analizojë shkaqet e ndodhjes së tyre me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie. Në koordinim me Avokatin Shtetëror të sigurohen informata/dëshmi që të sigurohet përfaqësim adekuat i këtyre rasteve/lëndeve.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pazbatuar
16	Rekomandim i vitit paraprak	Ministri duhet të siguroj se do të hartohet një plan veprimi i rishikuar ku janë vendosur zyrtarët përgjegjës, aktivitetet dhe afatet kohore për zbatim. Procesi duhet të monitorohet në bazë periodike nga menaxhmenti.	Nuk janë ndërmarr veprime për korrigjim.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar
17	NJAB	Ministri duhet të siguroj funksionimin e duhur të kontrolleve të brendshme në Ministri. Në këtë aspekt duhet siguar funksionimi i plotë i KA si dhe punë/auditime cilësore të NJAB. Më tutje, Menaxhmenti duhet siguroj zbatimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga NJAB.	Janë ndërmarr veprime, komiteti auditimit ishte funksionale, mirëpo niveli i implementimit të rekomandimeve nuk ishte i kënaqshëm	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
18	Kontrolle menaxheriale	Ministri duhet të siguroj cilësi në raportimet financiare dhe operative të Ministrisë. Te siguroj menaxhim dhe kontrolle efektive në realizimin e projekteve/kontratave për organizatat tjera. Gjithashtu, një qasje e planifikuar dhe e formalizuar për proceset/programet në kuadër të IKAP. Në planin e integritet të përfshihen definohen veprimet rigoroze ndaj rasteve të mundshme të mashtrimit apo korrupsionit.	Janë ndërmarr veprime të mjaftueshme	Rekomandim i zbatuar.
N r	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		

1	PFV	Rekomandimi A1 Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e parregullta për pagat e tyre dhe për qiranë e objekteve për zyre. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, Ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.
2	PFV	Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj se do të rritet kujdesi gjatë hartimit të buxhetit duke i klasifikuar drejt shpenzimet sipas . planit kontabël i aprovuar nga ana e Thesarit-MF dhe udhëzimit administrativ 05/2018 për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve.
3	PFV	Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj funksionimin adekuat dhe sistematik të kontrollit lidhur me plotësinë e regjistrave të pasurisë dhe se Pasqyrat Financiare Vjetore do t'i nënshtrohen rishikimit dhe vlerësimit rigoroz nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, para se deklarata të nënshkruhet dhe PFV të dorëzohen në Ministrinë e Financave.
4	Mallra dhe shërbime	Rekomandimi A3 Ministri duhet ndërmarrë veprime për tu siguruar se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta /Kontrata pune për detyra specifike, bëhet vetëm në rastet specifike kur ndonjë projekt apo punë e caktuar nuk mund të kryhet me stafin aktual brenda institucionit, dhe angazhimi i tyre të bëhet përmes një procesi transparent dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore
5	Mallra dhe shërbime	Rekomandimi B2 Ministri të siguroj se obligimet e papaguara duhet të trajtohet me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha faturat.
6	Investime kapitale	Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që për të gjitha projektet kapitale të bëjë planifikimin e duhur për të gjitha vitet dhe çdo kontratë të ketë buxhet të mjaftueshmë mbi shpenzimin e kontraktuar
7	Investime kapitale	Rekomandimi A5 Ministri duhet të rrisë kontrollet në menaxhimin e shpenzimeve për projekte kapitale dhe të siguroj se paradhëniet do të ndodhin me arsyeshmëri të duhur sipas kërkesave kontraktuale.
8	Investime kapitale	Rekomandimi C1 Ministri duhet të forcoj masat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies të zyrtarëve përgjegjës me rastin e aprovimit të kërkesave për pagesat e paradhënies.
9	Pasuritë	Rekomandimi B3 Ministri duhet të qartësoj kërkesat rregullative, të nxjerrë udhëzim të brendshëm lidhur me inventarizimin e pasurisë jofinanciare dhe të trajtoj stafin relevant.
10	Obligime	Rekomandimi B4 Ministri duhet të siguroj se shpenzimet e buxhetit i përmbahen kufijve buxhetor dhe mbi këtë bazë të bëhet planifikimi i buxhetit dhe plani i rrjedhës së parasë të ju përgjigjet nevojave reale të ministrisë.
11	Detyrime Kontigjente.	Rekomandimi B5 Ministri duhet të siguroj që për detyrimet kontingjente të bëhet një vlerësim i rrezikut me qëllim të planifikimit më të mirë financiar, të analizojë shkaqet e ndodhjes së tyre me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie.

12	NJAB	Rekomandimi C2 Ministri duhet të siguroj që fushëveprimi i auditimit të jetë për vitin aktual me qëllim që eliminimi i mangësive në sisteme të bëhet me kohë, e jo pasi që ngjarjet të kenë përfunduar, të ndërmer masa që rekomandimet e dhëna nga NJAB të adresohen dhe komitetin e auditimit të mbaj përgjegjës për rolin mbikëqyrës.
----	------	---

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Administracije - Ministry of Public Administration

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Administratës Publike për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

Z. Artan Berisha

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike

Data: 22.maj.2019, Prishtinë,



DATE/A:	14.05.2019
---------	------------